

Bazuar në nenin 35, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1, dhe nenin 65, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L-150, si dhe në pajtim me nenin 12 të Rregullores për Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare, Bordi Ekzekutiv i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 15 shtator 2025, miratoi këtë:

UDHËZIM

PËR PLATFORMËN PËR KRAHASIMIN E PRODUKTEVE DHE SHËRBIMEVE FINANCIARE

Neni 1 **Qëllimi**

Qëllimi i këtij Udhëzimi është të përcaktojë formën dhe mënyrën e raportimit të institucioneve financiare mbi normat, tarifrat dhe karakteristikat e produkteve dhe shërbimeve financiare për konsumatorët individualë, të shpalosura në Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare (në tekstin e mëtejme “Platforma”) të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK).

Neni 2 **Fushëveprimi**

1. Ky Udhëzim zbatohet nga institucionet financiare të licencuara, regjistruara ose autorizuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve financiare në pajtim me Rregulloren për Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare dhe këtë Udhëzim.
2. Institucionet financiare janë të obliguara të sigurojnë që informacioni i publikuar dhe raportuar të jetë i saktë, i plotë dhe i përditësuar, duke u siguruar kështu që konsumatorët të kenë qasje të barabartë në të dhëna të besueshme për informim dhe krahasimin e produkteve dhe shërbimeve financiare.

Neni 3

Funksionimi i Platformës

Platforma është një aplikacion që menaxhohet nga BQK, që ka për qëllim ofrimin e informacionit të standardizuar, të krahasueshëm dhe të përditësuar të produkteve dhe shërbimeve financiare të ofruara nga institucionet financiare të licencuara, regjistruara ose autorizuar nga BQK.

Neni 4

Raportimi, përdorimi dhe administrimi

1. Institucionet financiare të licencuara, regjistruara ose autorizuar nga BQK për ofrimin e produkteve dhe shërbimeve financiare obligohen të raportojnë në Platformë informatat mbi normat, tarifrat dhe karakteristikat kryesore të shpalosura në Platformë, sipas formatit të standardizuar nga BQK, dhe në përputhje me kushtet/kërkesat e shtojcave përkatëse të këtij Udhëzimi.
2. Secili institucion financiar do të bëjë vendosjen/plotësimin dhe përditësimin e të dhënave të veta në platformë, përmes komunikimit me *Excel*, *IPA* apo *XML* varësisht si dakordohet paraprakisht me Bankën Qendrore.
3. Institucionet financiare do të plotësojnë të dhënat që janë të sakta dhe të plota, si dhe do të përditësojnë të dhënat kurdo që bëjnë ndryshime në çmimoret e tyre apo kurdo që hyjnë në fuqi tarifrat dhe normat e reja të secilit institucion.
4. BQK do të krijojë shfrytëzues për secilin institucion pjesëmarrës, që do të jenë përgjegjës për administrimin e shfrytëzuesve tjerë nga ai institucion, duke përfshirë krijimin dhe bllokimin e shfrytëzuesve jo-administrativ dhe ndërrimin e fjalëkalimeve të tyre. Kërkesa për krijimin apo pasivizimin përdoruesve administrativ do të bëhet përmes sistemit që do të ofrohet nga BQK.
5. Plotësimi i të dhënave do të bëhet nga institucionet financiare, përmes shfrytëzuesve të secilit institucion, të cilët janë përgjegjës për plotësimin dhe përditësimin e të dhënave, e që kanë qasje të ndërhyjnë vetëm tek të dhënat e institucionit të vet dhe në asnjë rubrikë apo fushë tjetër.
6. Platforma do të përdoret nga konsumatorët për informim, edukim dhe krahasim të informatave të produkteve dhe shërbimeve të institucioneve financiare.
7. Renditja e institucioneve financiare në Platformë bëhet në bazë të datës së licencimit të secilit institucion.



8. Në rast të mospërputhjes ndërmjet Rregullores për Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare dhe këtij Udhëzimi, konsiderohet mbizotëruese Rregullorja.

Neni 5

Udhëzimet teknike për institucionet bankare

1. Institucionet bankare janë të obliguara të raportojnë të dhënat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren për Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare dhe në këtë Udhëzim.
2. Udhëzimet teknike për raportim janë të përcaktuara në Shtojcën I të këtij Udhëzimi.

Neni 6

Udhëzimet teknike për institucionet mikrofinanciare

1. Institucionet mikrofinanciare janë të obliguara të raportojnë të dhënat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren për Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare dhe në këtë Udhëzim.
2. Udhëzimet teknike për raportim janë të përcaktuara në Shtojcën II të këtij Udhëzimi.

Neni 7

Udhëzimet teknike për institucionet financiare jo-bankare

1. Institucionet financiare jo-bankare janë të obliguara të raportojnë të dhënat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren për Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare dhe në këtë Udhëzim.
2. Udhëzimet teknike për raportim janë të përcaktuara në Shtojcën III të këtij Udhëzimi.

Neni 8

Udhëzimet teknike për kompanitë e sigurimeve

1. Kompanitë e sigurimeve janë të obliguara të raportojnë të dhënat në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Rregulloren për Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare dhe në këtë Udhëzim.
2. Udhëzimet teknike për raportim janë të përcaktuara në Shtojcën IV të këtij Udhëzimi.

Neni 9

Manualet për përdorim

Manualet e përdorimit për përdoruesit e institucioneve financiare do të përgatiten dhe shpalosen në Platformë nga BQK dhe të njëjtat do të përditësohen sipas ndryshimeve rregullative e teknologjike.

Neni 10

Shtojcat

Pjesë përbërëse e këtij Udhëzimi janë Shtojcat I-IV:

Shtojca I– Udhëzime për plotësimin e tabelave për produktet dhe shërbimet e institucioneve bankare;

Shtojca II– Udhëzime për plotësimin e tabelave për produktet dhe shërbimet e institucioneve mikrofinanciare;

Shtojca III– Udhëzime për plotësimin e tabelave për produktet dhe shërbimet e institucioneve financiare jo-bankare;

Shtojca IV– Udhëzime për plotësimin e tabelave për produktet dhe shërbimet e kompanive të sigurimit.

Neni 11

Periudha e përshtatjes me kërkesat

Institucionet financiare do të kenë kohë për të përshtatur, përditësuar dhe plotësuar sipas formatit të standardizuar të gjitha produktet që kërkohen me Rregulloren për Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare dhe këtë Udhëzim deri më 31 dhjetor 2025.

Neni 12

Hyrja në fuqi

Ky Udhëzim hyn në fuqi nga data 29 shtator 2025.



Ahmet Ismaili
Kryesues i Bordit Ekzekutiv

SHTOJCA I

Udhëzime për plotësimin e tabelave për produktet dhe shërbimet e institucioneve bankare

Kjo shtojcë përmban udhëzime teknike për plotësimin e të dhënave në tabelat që ndërlidhen me produktet bankare në kuadër të Platformës për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare.

Të dhënat në Platformë do të plotësohen në 3 gjuhë: gjuhë shqipe, gjuhë serbe dhe gjuhë angleze.

Në platformë do të shpalosen produktet bankare më të përdorura si në vijim:

Llogaritë bankare - llogari rrjedhëse, llogari pagese me shërbime bazike, llogari pagese me shërbime bazike për kategori të konsumatorëve të cenueshëm, llogari studentore, llogari të kursimit, llogari të kursimit për fëmijë;

Kreditë - kredi personale, kredi hipotekare, kredi për renovim të shtëpisë, kredi për vetura, kredi të mbuluara me para të gatshme, mbitërheqje;

Depozitat - Depozita 6, 12, 24, 36, 48 dhe 60 mujore;

Kartela bankare - kartela krediti, kartela debiti;

Shërbimet e transferimeve dhe pagesave - Transfere brenda bankës, transfere kombëtare dalëse, transfere kombëtare hyrëse, transfere ndërkombëtare dalëse, transfere ndërkombëtare hyrëse dhe pagesa të faturave.

1. Udhëzime për plotësimin e të dhënave për llogaritë

- Formatimi i vlerave numerike:
 - Vlerat shënohen vetëm si numra – pa njësi matëse.
 - ▶ Shembull: Në vend të 0.10%, shkruani 0.10
 - Në vend të 5.00 €, shkruani 5.00
- Nëse tarifa apo vlera nuk aplikohet:
 - Shkruani "N/A" (jo e zbrazët, jo "0").
- Nëse tarifa ekziston por është zero (0):
 - Shkruani 0.
- Nëse produkti nuk ofrohet nga institucioni:
 - Shkruani "Nuk ofrohet"
- Formatimi i qelizave:

- Të gjitha qelizat me vlera duhet të jenë në format "*General*" (jo "*Currency*" apo "*Percentage*").
- Të fushat ku kërkohet përgjigje me tekst, të plotësohet vetëm "*Po*" ose "*Jo*".

Fusha	Përshkrimi
Mirëmbajtja mujore e llogarisë	Tarifa mujore që aplikohet për mirëmbajtjen e llogarisë.
Tarifa për hapje	Shuma që paguan konsumatori për të hapur llogarinë.
Tarifa për lëshim të debit kartelës	Tarifa për lëshimin e kartelës së debitit për herën e parë.
Tarifa për mirëmbajtje të kartelës	Tarifa për mirëmbajtjen mujore për debit kartelën
Tarifa për mbyllje	Tarifa që aplikohet në rast të mbylljes së llogarisë nga klienti.
Bilanci minimal	Shuma minimale që duhet të deponohet në llogari në momentin e hapjes së llogarisë.
Norma nominale e interesit (%)	Përqindja vjetore e interesit, fikse ose e ndryshueshme, e aplikuar mbi shumën e depozitës në llogarinë e kursimit.
Norma efektive e interesit (%)	Përqindja totale e kthimit nga llogaria e kursimit, e llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar në Rregulloren për Shpalosje dhe Normën Efektive të Interesit, duke përfshirë interesin e përbërë dhe të gjitha elementet që ndikojnë në kthimin real të depozitës.

2. Udhëzime për plotësimin e të dhënave për kreditë

- Nëse tarifa apo karakteristika nuk aplikohet, shëno "N/A"
- Nëse vlera është 0, shëno 0
- Nëse produkti nuk ofrohet nga institucioni, shkruani "Nuk ofrohet"
- Nëse qeliza përmban vetëm vlerë numerike, mos përdor njësi si EUR, % ose € – shëno vetëm vlerën numerike (format i përgjithshëm / *general*)



- Për pyetje që kërkojnë përgjigje me tekst, përdor vetëm "Po" ose "Jo" (p.sh. Kërkesa për bashkëhuamarrës / garantues).

Fusha	Përshkrimi
Norma nominale e interesit	Shkalla e interesit e shprehur si përqindje fikse apo e ndryshueshme e deklaruar nga institucioni, e cila përfaqëson përqindjen e kthimit që një individ do ta paguajë për një kredi.
Norma efektive e interesit	Kosto totale e kredisë së paraqitur si normë vjetore e vlerës totale të kredisë e llogaritur sipas metodologjisë të përcaktuar në Rregulloren për Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalosje.
Tarifa për disbursim të kredisë	Tarifa/Përqindja që aplikohet në momentin e lëshimit të kredisë.
Maturiteti minimal i kredisë	Periudha minimale e shprehur në muaj për të cilën jepet kredia.
Maturiteti maksimal i kredisë	Periudha maksimale e shprehur në muaj për të cilën jepet kredia.
Tarifa për ristrukturim	Tarifa që aplikohet në rast të ndryshimit të kushteve të kontratës së kredisë (p.sh. zgjatje e afatit ose shkurtim i afatit).
Tarifa për parapagim të kredisë	Tarifa që mund të aplikohet nëse konsumatori vendos të shlyejë kredinë përpara afatit të kontraktuar.
Kërkesa për bashkëhuamarrës	Të plotësohet nëse kërkohet bashkëhuamarrës me "Po" ose "Jo".
Kërkesa për garantues	Të plotësohet nëse kërkohet garantues me "Po" ose "Jo".
Mbulueshmëria me hipotekë/kolateral	Të plotësohet me "Po" ose "Jo" për kërkesën për hipotekë ose kolateral; nëse 'Po', të plotësohet edhe përqindja e mbulimit.
Norma fikse e interesit	Norma e interesit që nuk ndryshon gjatë një periudhe të caktuar të kredisë. Jepet si përqindje.
Norma e ndryshueshme e interesit	Norma nominale e interesit (%) tregon normën bazë të interesit, e cila mund të ndryshojë gjatë afatit të kredisë në varësi të indeksit referues si EURIBOR.
Norma e kombinuar e interesit	Kombinim i normës fikse dhe asaj të ndryshueshme për periudha të ndryshme gjatë afatit të kredisë.

Fusha	Përshkrimi
Maturiteti i periudhës fikse	Kohëzgjatja në muaj kur aplikohet norma fikse për produktin me interes të kombinuar.
Shuma minimale (kreditë e mbuluara me para të gatshme)	Të plotësohet shuma minimale e kredisë në vlerë absolute (EUR), që banka ofron për kredi të cilat janë 100% të kolateralizuara me para të gatshme si depozitë apo fonde të bllokuara.
Shuma maksimale (kreditë e mbuluara me para të gatshme)	Të plotësohet shuma maksimale e kredisë në vlerë absolute (EUR), që banka ofron për kredi të cilat janë 100% të kolateralizuara me para të gatshme si depozita apo fonde të bllokuara.
Shuma minimale (Mbitërheqja)	Të plotësohet numri minimal i pagave të nevojshme për të lejuar miratimin e mbitërheqjes (<i>overdraft</i>). Nëse banka aplikon edhe një limit minimal të shprehur në vlerë absolute (në euro), atëherë të specifikohet si numri minimal i pagave ashtu edhe shuma minimale në vlerë absolute. Shembull: 1 pagë (minimum 300 euro)
Shuma maksimale (Mbitërheqja)	Të plotësohet numri maksimal i pagave të nevojshme për të lejuar miratimin e mbitërheqjes (<i>overdraft</i>). Nëse banka aplikon edhe një limit maksimal të shprehur në vlerë absolute (në euro), atëherë të specifikohet si numri maksimal i pagave ashtu edhe shuma maksimale në vlerë absolute. Shembull: 1 pagë (maksimumi 5000 euro)

3.Udhëzime për plotësimin e të dhënave për depozita

- Nëse një element nuk aplikohet, shëno "N/A"
- Nëse vlera është 0, shëno 0
- Nëse produkti nuk ofrohet nga institucioni: shkruani "Nuk ofrohet"
- Përdor vetëm vlera numerike – mos përdor simbolin %, EUR, €, apo ndonjë njësi tjetër
- Të gjitha normat (nominale/efektive) jepen vetëm si vlerë numerike
 - ▶ Shembull: Në vend të 0.10%, shkruani 0.10
 - Në vend të 5.00 €, shkruani 5.00

Fusha	Përshkrimi
Shuma minimale	Të plotësohet shuma minimale që klienti duhet të deponojë për të hapur një depozitë me afat.
Shuma maksimale	Të plotësohet shuma maksimale që klienti duhet të deponojë për të hapur një depozitë me afat.
Norma nominale e interesit	Shkalla e interesit e shprehur si përqindje fikse apo e ndryshueshme e deklaruar nga institucioni, që do t'i paguaj klientit për shumën e depozituar.
Norma efektive e interesit	Norma e kthimit nga depozita, e shprehur si normë vjetore, që përfaqëson kthimin total të fituar nga depozita, e llogaritur sipas metodologjisë së përcaktuar në Rregulloren për Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalosje.

4. Udhëzime për plotësimin e të dhënave për kartela

- Nëse tarifa nuk aplikohet, shëno "N/A"
- Nëse vlera është 0, shëno 0
- Nëse produkti nuk ofrohet nga institucioni, shkruani "Nuk ofrohet"
- Përdor vetëm vlera numerike (mos përdor EUR, %, € apo njësi të tjera)
- Për pyetjet që kërkojnë tekst ("Po"/"Jo") – shëno vetëm "Po" ose "Jo"
- Të gjitha normat (nominale/efektive) jepen vetëm si vlerë numerike
 - ▶ Shembull: Në vend të 0.10%, shkruani 0.10
 - Në vend të 5.00 €, shkruani 5.00

Fusha	Përshkrimi
Tarifa për lëshim të kartelës	Tarifa për lëshimin e kartelës së debitit për herën e parë.
Tarifa për mirëmbajtje të kartelës	Tarifa për mirëmbajtjen mujore për debit kartelën.
Tarifa për tërheqje në ATM të bankës	Tarifa e shprehur në përqindje për tërheqjen e parave të gatshme në bankomatit e bankës suaj.
Tarifa për tërheqje në ATM të bankave tjera në Kosovë	Tarifa e shprehur në përqindje për tërheqjen e parave të gatshme në bankomatet e bankave të tjera brenda Kosovës.
Tarifa për tërheqje në ATM jashtë vendit	Tarifa e shprehur në përqindje për tërheqjen e parave të gatshme në bankomatet e bankave të tjera jashtë Kosovës.
Tarifa për deponim në ATM të bankës	Tarifa e shprehur në përqindje që aplikohet për depozitim të parave në ATM të bankës suaj.
Pagesat në internet	Tarifa e shprehur në përqindje që aplikohet për pagesat në internet.
Tarifa për zëvendësimin e kartelës së humbur, vjedhur apo të dëmtuar	Tarifa që aplikohet për lëshimin e kartelës zëvendësuese.
Tarifa për këmbim të valutave me rastin e transaksioneve jashtë vendit	Tarifa e shprehur në përqindje që zbatohet për transaksione me valutë të huaj jashtë Kosovës.
Norma vjetore e interesit për pagesë maksimale	Norma vjetore e interesit (në përqindje) që aplikohet kur klienti paguan të gjithë detyrimin e shfrytëzuar nga kredit kartela brenda periudhës së lejuar pa interes.
Norma vjetore e interesit për pagesë minimale	Norma vjetore e interesit (në përqindje) që aplikohet mbi shumën e papaguar pas kryerjes së pagesës minimale mujore nga klienti.
Norma vjetore e interesit për pagesë me këste	Norma vjetore e interesit (në përqindje) që aplikohet për pagesën me këste mujore të shumës së përdorur.
Shuma maksimale e kësteve mujore	Numri maksimal i kësteve që banka ofron për shlyerjen e detyrimit në kuadër të kredit kartelës
Limiti i tërheqjes mujore në para të gatshme	Limiti maksimal i shumës që mund të tërhiqet në para të gatshme nga kartela e kreditit.



5. Udhëzime për plotësimin e të dhënave për Transfere dhe Pagesa

- Nëse tarifa nuk aplikohet, shëno "N/A"
- Nëse vlera është 0, shëno 0
- Nëse produkti nuk ofrohet nga institucioni, shkruani "Nuk ofrohet"
- Përdor vetëm vlera numerike (mos përdor EUR, %, € apo njësi të tjera)
- Për pyetjet që kërkojnë tekst ("Po"/"Jo") – shëno vetëm "Po" ose "Jo"
- Të gjitha normat (nominale/efektive) jepen vetëm si vlerë numerike
 - ▶ Shembull: Në vend të 0.10%, shkruani 0.10
 - Në vend të 5.00 €, shkruani 5.00

Fusha	Përshkrimi
Transferet brenda klientit të njëjtë – në degë	Tarifa për transferin e realizuar në degë ndërmjet llogarive të klientit brenda bankës së njëjtë.
Transferet brenda klientit të njëjtë - me e-banking	Tarifa për transferin e realizuar me e-banking ndërmjet llogarive të klientit brenda bankës së njëjtë.
Transferet në mes klientëve të ndryshëm – Në degë	Tarifa për transferin e realizuar në degë, brenda bankës së njëjtë në mes të klientëve të ndryshëm.
Transferet në mes klientëve të ndryshëm – Me e-banking	Tarifa për transferin e realizuar me e-banking, brenda bankës së njëjtë në mes të klientëve të ndryshëm.
Transferet dalëse ≤ 10,000 EUR – Në degë	Tarifa për transferet që realizohen në degë, brenda Kosovës deri në 10,000 EUR.
Transferet dalëse ≤ 10,000 EUR – Me e-banking	Tarifa për transferet që realizohen me e-banking, brenda Kosovës deri në 10,000 EUR.
Transferet dalëse > 10,000 EUR – Në degë	Tarifa për transferet që realizohen në degë, brenda Kosovës mbi 10,000 EUR.
Transferet dalëse > 10,000 EUR – Me e-banking	Tarifa për transferet që realizohen me e-banking, brenda Kosovës mbi 10,000 EUR
Transferet me prioritet – në degë	Tarifa për transferet urgjente të realizuara në degë.
Transferet me prioritet – Me e-banking	Tarifa për transferet urgjente të realizuara me e-banking.
Transferet kombëtare hyrëse	Tarifa për pranimin e mjeteve nga një bankë tjetër brenda Kosovës.

Fusha	Përshkrimi
Komisioni minimal – Në degë – OUR	Tarifa minimale për transferet ndërkombëtare me shpenzime të bartura nga dërguesi (OUR), të realizuara në degë.
Komisioni minimal – Në degë – SHA/BEN	Tarifa minimale për transferet ndërkombëtare me ndarje të shpenzimeve, të realizuara në degë.
Komisioni minimal – Me e-banking – OUR	Tarifa minimale për transferet ndërkombëtare me shpenzime të bartura nga dërguesi (OUR), të realizuara me e-banking.
Komisioni minimal – Me e-banking – SHA/BEN	Tarifa minimale për transferet ndërkombëtare me ndarje të shpenzimeve, të realizuara me e-banking.
Komisioni maksimal - Në degë – OUR	Tarifa maksimale për transferet ndërkombëtare me shpenzime të bartura nga dërguesi (OUR), të realizuara në degë.
Komisioni maksimal Në degë – SHA/BEN	Tarifa maksimale për transferet ndërkombëtare me ndarje të shpenzimeve, të realizuara në degë.
Komisioni maksimal - Me e-banking – OUR	Tarifa maksimale për transferet ndërkombëtare me shpenzime të bartura nga dërguesi (OUR), të realizuara me e-banking.
Komisioni maksimal Me e-banking – SHA/BEN	Tarifa maksimale për transferet ndërkombëtare me ndarje të shpenzimeve, të realizuara me e-banking.
Komisioni minimal për transferet ndërkombëtare hyrëse	Tarifa minimale që aplikohet për pranimin e mjeteve nga jashtë.
Komisioni maksimal për transferet ndërkombëtare hyrëse	Tarifa maksimale që aplikohet për pranimin e mjeteve nga jashtë.
Pagesa KESCO – Në degë	Tarifa për pagesë të faturës së energjisë në degë.
Pagesa KESCO – Me e-banking	Tarifa për pagesë të faturës së energjisë përmes e-banking.
Pagesa studentore – Në degë	Tarifa për pagesat studentore - për regjistrim, pagës të semestrit, etj. Të realizuara në degë.
Pagesa studentore – Me e-banking	Tarifa për pagesat studentore - për regjistrim, pagesë të semestrit, etj. Të realizuara me e-banking.
Pagesa e tatimeve – Në degë	Tarifa për pagesat e detyrimeve tatimore të realizuara në degë.
Pagesa e tatimeve – Me e-banking	Tarifa për pagesat e detyrimeve tatimore të realizuara me e-banking.
Pagesat për kompani të sigurimeve – Në degë	Tarifa për pagesë për kompanitë e sigurimeve të realizuara në degë.
Pagesat për kompani të sigurimeve – Me e-banking	Tarifa për pagesë për kompanitë e sigurimeve të realizuara me e-banking.
Pagesat për Policinë e Kosovës – Në degë	Tarifa për pagesa për Policinë e Kosovës, të realizuara në degë.
Pagesat për Policinë e Kosovës – Me e-banking	Tarifa për pagesa për Policinë e Kosovës, të realizuara me e-banking.

6. Udhëzime për plotësimin e të dhënave për shërbime nw pako

6.1 Udhëzime për plotësimin e të dhënave për Pako 1

- **Emërtimi i Pakos** – Të plotësohet emri i pakos, ashtu siç përdoret zyrtarisht në bankë (p.sh Pako Bazike)
- **Çmimi mujor i pakos:** - Të plotësohet me vlerë absolute (EUR) p.sh 0.50 EUR/muaj
- **Shërbimet e përfshira** duhet të shënohen me ✓ nëse ofrohen pa kosto shtesë si pjesë e pakos, ose ✗ nëse nuk janë të përfshira.

Lista e Shërbimeve të përfshira në Pako 1

Shërbimi	I përfshirë në pako
Hapja e llogarisë rrjedhëse	
Mirëmbajtja e llogarisë rrjedhëse	
Hapja e llogarisë së kursimit	
Mirëmbajtja e llogarisë së kursimit	
Hapja e llogarisë së depozitave me afat	
Mirëmbajtja e llogarisë së depozitave me afat	
Lëshimi i kartelës debitore	
Aktivizimi i E-Banking / M-Banking	
Aktivizimi dhe mirëmbajtja e shërbimit SMS Njoftim	
Aktivizimi dhe mirëmbajtja e shërbimit SMS Bilanci	
Aktivizimi dhe mirëmbajtja e shërbimit SMS Top UP	
Tërheqjet në bankomatin e bankës	
Deponimet në bankomatin e bankës	
Transferet brenda bankës përmes E-Banking	
Transferet kombëtare përmes E-Banking	
Giro pagesat për kompani publike përmes E-Banking	



6.2 Udhëzime për plotësimin e të dhënave për Pako 2

- **Emërtimi i pakos** – Të plotësohet emri i pakos, ashtu siç përdoret zyrtarisht në bankë (p.sh Pako Standard)
- **Çmimi mujor i pakos:** - Të plotësohet me vlerë absolute (EUR) p.sh 0.50 EUR/muaj
- **Shërbimet e përfshira** duhet të shënohen me nëse ofrohen pa kosto shtesë si pjesë e pakos, ose nëse nuk janë të përfshira.

Lista e Shërbimeve të përfshira në Pako 2

Shërbimi	I përfshirë në pako
Hapja dhe mirëmbajtja e llogarisë rrjedhëse	
Hapja dhe mirëmbajtja e llogarisë së kursimeve	
Hapja dhe mirëmbajtja e llogarisë së kursimit për fëmijë	
Hapja dhe mirëmbajtja e llogarisë së depozitave me afat	
Lëshimi i kartelës debitore	
Rilëshimi i kartelës debitore	
Aktivizimi i E-Banking / M-Banking	
Aktivizimi dhe mirëmbajtja e shërbimit SMS Njoftim	
Aktivizimi dhe mirëmbajtja e shërbimit SMS Bilanci	
Aktivizimi dhe mirëmbajtja e shërbimit SMS Top UP	
Tërheqjet në bankomatit e bankës	
Deponimet në bankomatit e bankës	
Transferet brenda bankës përmes E-Banking	
Transferet kombëtare përmes E-Banking	
Lëshimi i kartelës kreditore	
Rilëshimi i kartelës kreditore	
Giro pagesat për kompani publike përmes E-Banking	
Lëshimi i pasqyrës së llogarisë	

6.3 Udhëzime për Plotësimin e Pakove në Platformë

Institucionet bankare mund të shpalosin pakot e produkteve dhe shërbimeve të tyre në Platformë, duke respektuar formatin/tabelat e pakove, që gjendet në Platformë – te pjesa e pakove.

Për çdo pako të shpalosur, duhet të përfshihen këto elemente:

- Të zgjidhet institucioni
- Emërtimi i pakos;
- Shuma e çmimit (e shprehur në euro, si vlerë e plotë);
- Lista e plotë e elementeve dhe shërbimeve të përfshira në pako.

SHTOJCA II

Udhëzime për plotësimin e tabelave për produktet dhe shërbimet e institucioneve mikrofinanciare

Kjo shtojcë përmban udhëzime teknike për plotësimin e të dhënave në tabelat që ndërlidhen me produktet e institucioneve mikrofinanciare në kuadër të Platformës për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare.

Të dhënat në platformë do të plotësohen në 3 gjuhë: gjuhë shqipe, gjuhë serbe dhe gjuhë angleze.

1. Udhëzime për plotësimin e tabelave me të dhëna

Platforma lexon vetëm faqen apo “*sheet-in*” e parë në file të *excel-it*.

Institucionet mikrofinanciare duhet të përdorin shabllone të ndara për secilën kategori të klientit për produkt. Kjo nënkupton që për kategoritë “Klient i Ri” dhe “Klient Ekzistues” duhet të përdoren dy dokumente të ndryshme (dy *files* të ndryshëm).

- Formatimi i vlerave numerike:
 - Vlerat shënohen vetëm si numra – pa njësi matëse.
 - ▶ Shembull: Në vend të 18.50%, shkruani 18.50
 - Në vend të 1000 €, shkruani 1000.00
- Nëse tarifa apo karakteristika nuk aplikohet:
 - Shëno "N/A" (jo bosh, jo "0")
- Nëse vlera është zero (0):
 - Shëno 0
- Formatimi i qelizave:
 - Të gjitha qelizat me vlera duhet të jenë në format "*General*" (jo "*Currency*" apo "*Percentage*")
- Për pyetje që kërkojnë përgjigje me tekst:
 - Përdor vetëm "*Po*" ose "*Jo*"

2. Plotësimi i të dhënave për produktet e kredisë

2.1 Klient i Ri apo Klient Ekzistues

Fusha	Përshkrimi
Maturiteti minimal i kredisë	Kohëzgjatja më e shkurtër e kredisë, e shprehur në muaj.
Maturiteti maksimal i kredisë	Kohëzgjatja më e gjatë e kredisë, e shprehur në muaj.
Norma nominale e interesit	Shkalla e interesit e shprehur si përqindje fikse apo e ndryshueshme e deklaruar nga institucioni, e cila përfaqëson përqindjen e kthimit që një individ do ta paguajë për një kredi.
Norma efektive e interesit	Kosto totale e kredisë së paraqitur si normë vjetore e vlerës totale të kredisë e llogaritur sipas metodologjisë të përcaktuar në Rregulloren për Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalosje.
Shpenzimet administrative	Tarifa që aplikohet në momentin e dhënies së kredisë. Jepet si shumë fikse ose përqindje e shumës së kredisë.
Kërkesa për garantues	Plotësohet me "Po" apo "Jo"
Kërkesa për bashkëhuamarrës	Plotësohet me "Po" apo "Jo"
Mbulueshmëria me kolateral të luajtshëm %	Të plotësohet me "Po" apo "Jo" për kërkesën për kolateral; nëse 'Po', të plotësohet edhe përqindja e mbulimit.

SHTOJCA III

Udhëzime për plotësimin e tabelave për produktet dhe shërbimet e institucioneve financiare jobankare

Kjo shtojcë përmban udhëzime teknike të detajuara për plotësimin e të dhënave në tabelat lidhur me produktet dhe shërbimet e institucioneve financiare jobankare. Të dhënat e paraqitura do të përdoren për publikim dhe krahasim në kuadër të Platformës për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare, në përputhje me kërkesat ligjore në fuqi.

Institucionet financiare jo-bankare janë të paraqitura në tabelat përkatëse të produkteve dhe shërbimeve për të cilat janë të licencuara nga BQK. Ky klasifikim siguron që çdo institucion të përfaqësohet vetëm në ato tabela që korrespondojnë me gamën reale të produkteve dhe shërbimeve që ofron, duke garantuar kështu një përputhje të saktë dhe të plotë të informacionit të publikuar në Platformën për Krahasimin e Produkteve dhe Shërbimeve Financiare.

Të dhënat në platformë do të plotësohen në 3 gjuhë: gjuhë shqipe, gjuhë serbe dhe gjuhë angleze.

Produktet dhe shërbimet e ofruara nga institucionet financiare jobankare janë të ndara në kategoritë dhe nënkategoritë e mëposhtme:

1. Kreditë:

- Kredi personale
- Kredi për pagesa
- Kredi hipotekare
- Kredi për vetura
- Kredi bujqësore

2. Llogari dhe kartela

3. Transfere:

- Transferet brenda institucionit
- Transferet kombëtare dalëse
- Transferet kombëtare hyrëse
- Transferet ndërkombëtare dalëse
- Transferet ndërkombëtare hyrëse

4. Pagesa:

- Pagesat KESCO
- Pagesat studentore
- Pagesat e tatimeve
- Pagesat për kompani e sigurimeve
- Pagesat për Policinë e Kosovës

1. Udhëzime për plotësimin e tabelave me të dhëna për kreditë:

- Formatimi i vlerave numerike:
 - Vlerat duhet të shënohen vetëm si numra, pa njësi matëse.
 - ▶ Shembull: Në vend të “0.10%” shkruani “0.10”.
Në vend të “5.00 €” shkruani “5.00”.
- Nëse tarifa apo vlera nuk aplikohet:
 - Shkruani "N/A" (nuk duhet të lihet e zbrazët ose të shkruhet "0").
- Nëse tarifa ekziston dhe është zero (0):
 - Shkruani 0.
- Nëse produkti nuk ofrohet nga institucioni:
 - Shkruani “Nuk ofrohet”
- Formatimi i qelizave:
 - Të gjitha qelizat me vlera duhet të jenë në formatin "*General*" (jo “Currency” apo “Percentage”).
- Në fushat ku kërkohet përgjigje tekstuale:
 - Të plotësohet vetëm “Po” ose “Jo”.

Fusha	Përshkrimi
Norma nominale e interesit	Shkalla e interesit e shprehur si përqindje fikse apo e ndryshueshme e deklaruar nga institucioni, e cila përfaqëson përqindjen e kthimit që një individ do ta paguajë për një kredi.
Norma efektive e interesit	Kosto totale e kredisë të paraqitur si normë vjetore e vlerës totale të kredisë e llogaritur sipas metodologjisë të përcaktuar në Rregulloren për Normën Efektive të Interesit dhe Kërkesat për Shpalesje.
Tarifa për disbursim të kredisë	Tarifa/Përqindja që aplikohet në momentin e lëshimit të kredisë.
Maturiteti minimal i kredisë	Periodha minimale e shprehur në muaj për të cilën jepet kredia.
Maturiteti maksimal i kredisë	Periodha maksimale e shprehur në muaj për të cilën jepet kredia.

Fusha	Përshkrimi
Kërkesa për bashkëhuamarrës	Të plotësohet nëse kërkohet bashkëhuamarrës me "Po" ose "Jo".
Kërkesa për garantues	Të plotësohet nëse kërkohet garantues me "Po" ose "Jo".
Mbulueshmëria me hipoteke	Të plotësohet me "Po" ose "Jo" për kërkesën për hipoteke nëse "Po", të plotësohet edhe përqindja e mbulimit.
